



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
MINISTRI

Nr. 2265/1 Prot.

Tiranë, më 26.042022

URDHËR

Nr. 84, datë 26.042022

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIDHJEN E MARREVESHJEVE  
HIDROKARBURE PËR BLOKUN "C" DHE BLOKUN "PANAJA"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", të ndryshuar, dhe të "Rregulloren për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licence marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse" të miratuar me Urdhër Ministri nr. 246, datë 12.03.2018, për zbatimin e synimit themelor për thithjen e investimeve të huaja, apo vendase, në fushën e kërkimit të naftës dhe gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht për blloqet e Lira të Kërkimit, si dhe për të garantuar zhvillimin e një procedure të hapur, konkurruese,

URDHËROJ:

1. Njoftimin për të ftuar subjektet e interesuara për pjesëmarrjen me anë të aplikimeve, për të lidhur marrëveshje hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në bllokun "C" dhe bllokun "Panaja" të kërkimit.
2. AKBN të publikojë menjëherë në faqen e saj të internetit hartën e bllokut "C" dhe bllokut të "Panajasë" të kërkimit si dhe formularin e aplikimit. Pjesë e këtij publikimi duhet të jetë edhe vendosja e afatit të dorëzimit të aplikimit për bllokun "C" dhe bllokun "Panaja", i cili duhet të jetë 90 ditë duke filluar nga data e njoftimit.

3. Dokumentacioni që do të publikohet të dërgohet në mënyrë zyrtare në MIE dhe një kopje e tij të dërgohet në adresën elektronike të saj. MIE të publikojë në faqen e saj të internetit këtë dokumentacion.
4. Në zbatim të pikës 2, të “Rregullore për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licence marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse”, AKBN të përcjellë në MIE dokumentacionin e shoqërive aplikuese dhe vlerësimin e tyre bazuar në kapacitetin teknik, financiar si dhe termat dhe kushtet kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure për secilin bllok.
5. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen AKBN, si dhe Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve në MIE.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**  
  
**Belinda Balluku**

